VENDIM
Nr.854, datë 5.8.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE DHE NË ATË TË MJEKËSISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

(Ndryshuar me VKM nr. 1169, datë 25.11.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në:

a) Filozofi, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në Filozofi".

b) Sociologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në Sociologji".

c) Pedagogji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në Pedagogji".

ç) Psikologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në Psikologji".

d) Punë sociale, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në Punë Sociale".

2. Hapjen në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në:

a) Studime të Thelluara në Farmakologji, Fiziologji, Fiziologji Patologjike, në përfundim të të cilave lëshohen diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.), përkatësisht, në Studime të Thelluara, në Farmakologji, Fiziologji, Fiziologji Patologjike".

b) Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve Infektive Emergjente dhe Riemergjente në Shqipëri, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore "Doktor (Dr.), në Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve Infektive Emergjente dhe Riemergjente në Shqipëri".

c) Shëndet publik, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në Shëndet publik".

ç) Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore "Doktor (Dr.), në Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës".

d) Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji".

dh) Studime të Thelluara në Kardiologji, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë

për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime të Thelluara në Kardiologji”.

e) Studime në Patologji Oro-Maxilo-Faciale, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Patologji Oro-Maxilo-Faciale”.

ë) Studime në Neuroshkencë, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Neuroshkencë”.

f) Studime në Obstetrikë-Gjinekologji, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Obstetrikë-Gjinekologji”.

g) Mjekësi Laboratorike, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Mjekësi Laboratorike”.

gj) Morfologji Klinike, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Morfologji Klinike”.

h) Sëmundjet Kirurgjikale, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sëmundjet Kirurgjikale”.

i) Imazheri, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Imazheri”.

j) Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore”.

k) Sëmundjet e syrit, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sëmundjet e syrit”.

l) Pediatri, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Pediatri”.

ll) Shkencat farmaceutike, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Shkencat Farmaceutike”.

m) Sëmundjet e brendshme, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sëmundjet e Brendshme”.

3. Kohëzgjatja e programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite dhe përfshin edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, për vitin 2009, janë, si më poshtë vijon:

A. Fakulteti i Shkencave Sociale:

a) Doktoratë në Filozofi	24;
b) Doktoratë në Sociologji	30;
c) Doktoratë në Pedagogji	14;
ç) Doktoratë në Psikologji	20;
d) Doktoratë në Punë Sociale	12;
B. Fakulteti i Mjekësisë:	
a) Doktoratë në Studime të Thelluara në Farmakologji, Fiziologji, Fiziologji Patologjike	10;
b) Doktoratë në Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve Infektive, Emergjente dhe Riemergjente, në Shqipëri	16;
c) Doktoratë në Shëndetin Publik	12;
ç) Doktoratë në Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës	12;
d) Doktoratë në Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji	10;
dh) Doktoratë në Studime të Thelluara në Kardiologji	6;

e) Doktoratë në Studime në Patologji Oro-Maxilo-Faciale 16;
ë) Doktoratë në Studime në Neuroshkencë 16;
f) Doktoratë në Studime në Obstetrikë-Gjinekologji 10;
g) Doktoratë në Mjekësi Laboratorike 12;
gj) Doktoratë në Morfologji Klinike 10;
h) Doktoratë në Sëmundjet Kirurgjikale 20;
i) Doktoratë në Imazheri 10;
j) Doktoratë në Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore 10;
k) Doktoratë në Sëmundjet e Syrit 10;
l) Doktoratë në Pediatri 10;
ll) Doktoratë në Shkencat Farmaceutike 10;
m) Doktoratë në Sëmundjet e Brendshme 12.

4/1. Për kandidatët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, përcaktohen 10 (dhjetë) kuota në programet e studimeve të doktoratës në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe 40 (dyzet) kuota në programet e studimeve të doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë. Këto kuota administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me kërkesat e institucioneve përkatëse zyrtare të vendeve nga vijnë kandidatët.

4/2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Tarifa e shkollimit është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, me këste, të caktuara nga fakulteti përkatës.

6. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha